

Çfarë duhet të bëjmë?

Si të veproni në rast të ortekut:

Para ortekut

Qëndro larg nga zonat e ortekeve,
Anashkalo shpatijet e dyshmita,
Provoni me shkop dëborën në shpatije.

Nëse vëreni rradhën e shtresave të forta dhe të buta në sipërfaqe, dhe nëse shtresa e fortë është në një substrat të butë dhe anasjelltas, ndaluni.

Gjatë ortekut:

Nëse rrëzoheni, LUFTONI me ortekun !

Është pak e besueshme të shpëtoni duke ikur

Bëni përpjekje që orteku mos t'ju përfshij brenda tij

Lironi shkopinjtë nga duart

Vendosni duart para fytyrës dhe krijoni hapësirë për frymëmarrje

Mos bëni lëvizje të panevojshme sepse harxhohet energjia juaj dhe ajri pa nevojë.

Bërtisni dhe thërrisni për ndihmë vetëm atëherë kur vëreni se shpëtimtarët janë mbi ju.

Pas ortekut:

Shpëtimi nga ortekejt:

Vetëm ndihma e menjëhershme mund të jetë e suksesshme.

Gjatë veprimeve për shpëtim mendoni se jeni në teren orteku dhe se mund të filloj një ortekejt i ri.

Mbani mend vendin ku ka/kanë humbur personat (shënoni me ndonjë pajisje)

Lajmëro fatkeqësinë

SI TA BËJMË LAJMËRIMIN ?

-Prezantohu

-Fol kurtë mbi ngjarjen e ndodhur

-Trego saktë vendin e ngjarjes

-Trego numrin e telefonit prej nga bëni thirrjen

-Mos e ndërpre lidhjen pa e dhënë informacionin e plotë



PROGRAMI I MENAXHIMIT TË FATKEQËSIVE

Bora dhe orteqet A JENI TË PËRGATITUR

NUMRAT ME RËNDËSI NË RAST EMERGENJENCE



093 ZJARRFIKSAT



112 QENDRA OPERATIVE REGJIONALE



092 POLICIA



Kryqi i Kuq i Kosovës

Ka misionin e vet:


"Të lehtësojë vuajtjet njerëzore të individëve dhe bashkësive të rrezikuara përmes programeve të fokusuara, prioritare dhe të qëndrueshme si ndihmë e autoriteteve qendrore dhe lokale në bazë të Parimeve themelore të lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe: Humaniteti, Paanësia, Neutraliteti, Pavarësia, Vullnetarizmi, Uniteti dhe Universaliteti."



KËSHILLA
Për vetëmbrojtje

Çfarë është orteku?

Orteku i dëborës është shkëputje e madhe e masës së dëborës nga shpatijet e pjerrëta të maleve.



Kur ndodhin orteqet?

Orteqet ndodhin më së shumti në dimër dhe në pranverën e hershme.

Orteku ndodh kur masa e dëborës papritmas rrëshqet në shpatije.

Kur pjerrtësia e shpatit është 30° deri 45°.

Shkaktarët e Ortekut janë:

- lloji i dëborës
- kthesa/pjerrtësia e shpatit
- forma dhe lloji i tokës
- pozicioni i shtresave të dëborës
- kushtet meteorologjike – ndikimit i erës.

Ortekët mund të krijohen nga erërat afër majave malore, të cilat e bartin dëborën sipërfaqësore nga ana e erës në anën e kundërt.

Ortekët më të shpeshtë shkaktohen nga vet njerëzit, më rrallë nga kafshët ose zërat intenziv.


Çfarë duhet të bëjmë?

Llojet e Ortekëve

Oktekët ndahen sipas gjendjes dhe llojit të reshjeve të dëborës.

Gjatë kohës së reshjeve të dëborës, dëborë mund të jetë e thatë apo e lagësht.

Për më tepër dëborë mund të jetë e shkapërderdhur dhe e ngjeshur.



Orteku nga dëborë e shkapërderdhur (dëborë e shkruft) është lloji më i rrezikshëm i orteqeve.

Ortekët e këtij lloji arrijnë shpejtësi më të madhe se 300 km/h dhe lartësi prej 20m.



Orteku nga dëborë e ngjeshur është i rrezikshëm dhe i paparashikueshëm.

Të gjitha shtresat e dëborës reagojnë si një shtresë e vetme.

Dëborë mund të ndahet në blloqe të vogla gjatë rënies, ose poshtë shpatit mund të rrëshqasin blloqe të mëdha akujsh.

Si të veproni kur personi i kapluar nga orteku është në rrezik jete?

Nëse i lënduari nuk merr frymë, pastroni rrugët e frymëmarrjes dhe ofroni frymëmarrje artificiale.

Nëse të lënduarit nuk i funksionon zemra dhe nuk ka qarkullim gjaku, zhvilloni masazh kardiak dhe frymëmarrje artificiale.

Nëqoftëse i lënduari ka gjakderdhje të madhe ndaloni gjakderdhjen, ngritni gjymtyrët në gjunjë, shtypni plagën, shtypni enët e gjakut që qojnë në plagë, lidheni plagën.

Nëse i lënduari është në shok – vendoseni në pozitë shoku, zvogëloni dhimbjen, qetësoni të lënduarin.



Masat mbrojtëse preventive nga ortekët e dëborës:

Mbrojtja e zonave të banuara nga ortekët mund të jetë aktive dhe pasive.

Mbrojtja aktive përfshin nxitjen artificiale (me anë të eksplozivëve) të ortekëve në shtresat e ulëta të dëborës.

Mbrojtja pasive përfshin vendosjen e mureve (mureve nga betoni, gambionave, pyllëzimit, etj.) në zonat e rrezikshme të cilat mund të ndryshojnë rrjedhën e ortekut ose ta pengojnë atë.